

Përmbajtja

1.	Hyrje.....	3
1.1	Shenjat dhe simptomat.....	4
1.2	Format e zakonshme të demencës	5
2.	Qëllimi dhe fokusi.....	6
2.1	Epidemiologjia	7
2.2	Popullata e caktuar	7
2.3	Dedikimi i udhërrefyesit	8
2.4	Pyetjet klinike.	8
3.	Metodologjia	9
3.1	Formatimi	9
3.2	Burimet.....	10
4.	Rekomandimet.....	10
4.1	Përfshirja e njerëzve që jetojnë me demencë në vendimet për kujdesin e tyre	11
4.1.1	Përfshirja e njerëzve në vendimmarrje	11
4.1.2	Dhënia e informacionit	12
4.1.3	Planifikimi i kujdesit paraprak	13
5.	Diagnoza.....	13
5.1	Vlerësimi fillestar nga ana e mjekut në kujdesin shëndetësor primar.....	13
5.1.2	Diagnoza në shërbimet e specializuara të diagnostikimit të demencës	14
	Teste plotësuese për demencë me trupat Lewy	18
5.1.5	Teste plotësuese për demencën vaskulare.....	18
6.	Trajtimi	19
6.1	Ndërhyrjet farmakologjike për demencën	19

6.1.1 Menaxhimi farmakologjik i sëmundjes Alzheimer.....	19
6.1.2 Menaxhimi farmakologjik i demencës jo-Alzheimer.....	21
6.1.3 Ilaçet që mund të shkaktojnë dëmtime njohëse	24
6.1.4 Menaxhimi i simptomave jo njohëse.....	24
6. 1.5 Trajtimi i agjitimit dhe sjelljes agresive me antipskoti atipik në krahasim me trajtimin jo-farmakologjik.....	25
6.1.8 Trajtimi sistematik i faktorëve vaskularë të rrezikut (hipertensionit, hiperkolesterolemisë, diabetit melit konkomitant), te pacientët me demencë.	28
7. Kujdesi paliativ.....	33
8. Mbështetja e kujdestarëve	33
9. Trajnimi dhe edukimi i stafit.....	34
10. Vënia në praktikë e këtij udhëzimi	35
11. Referencat	35
12. Shtojcat.....	45

Demenca: vlerësimi, menaxhimi dhe mbështetja për njerëzit që jetojnë me demencë dhe kujdestarët e tyre

1. Hyrje

Demenca është një term që përdoret për të përshkruar një sërë simptomash njohëse dhe të sjelljes e që mund të përfshijnë humbjen e kujtesës, probleme me arsyetimin, komunikimin dhe ndryshimin e personalitetit e që mund të manifestohet me një reduktim në aftësinë e një personi për të kryer aktivitete të përditshme si: pazari, larja, veshja. dhe gatimi.

Demenca është e shoqëruar me morbiditet më të lartë, mortalitet të shtuar dhe kualitet më të ulët të jetës në përgjithësi.

Sëmundja përkeqësohet me kalimin e kohës. Kryesisht prek njerëzit e moshuar, por me rritjen e moshës jo të gjithë njerëzit do të kenë demencë.

Faktorët që rrisin rrezikun e zhvillimit të demencës përfshijnë:

- mosha (më e zakonshme tek ata mbi 65 vjeç) , presioni i lartë i gjakut (hipertensioni)
- sheqeri i lartë në gjak (diabeti), mbipesha ose obeziteti, pirja e duhanit, alkoolit, mungesa e aktivitetit fizik , si dhe izolimi në aspektin social dhe depresioni.

Demenca është një sindromë që mund të shkaktohet nga një sërë sëmundjesh të cilat me kalimin e kohës shkatërrojnë qelizat nervore dhe dëmtojnë trurin, të cilat shpiejnë zakonisht në përkeqësim të funksionit njohës (dmth aftësinë për të përpunuar mendimin) përtej asaj që mund të pritet nga pasojat e zakonshme biologjike - plakjes. Derisa vetëdija nuk preket, dëmtimi në funksionin njohës zakonisht herë pas herë shoqërohet dhe mund të paraprihet nga ndryshimet në humor, në kontrollin emocional, në sjellje ose në motivim.

Demenca ka ndikime fizike, psikologjike, sociale dhe ekonomike, jo vetëm për njerëzit që jetojnë me demencë, por edhe për kujdestarët e tyre, familjet dhe shoqërinë në përgjithësi. Shpesh ka mungesë të vetëdijesimit shoqëror si dhe ka vështirësi në të kuptuarit e demencës, duke rezultuar në stigmatizim dhe në pengesa për diagnostikimin dhe kujdesin ndaj këtyre pacientëve.

1.1 Shenjat dhe simptomat

Ndryshimet në humor dhe sjellje ndonjëherë ndodhin edhe para se të shfaqen problemet e kujtesës. Simptomat përkeqësohen me kalimin e kohës. Përfundimisht, shumica e njerëzve me demencë do të kenë nevojë për ndihmen e të tjerëve për t'u ndihmuar në aktivitetet e përditshme.

Shenjat dhe simptomat e hershme janë:

- duke harruar gjërat ose ngjarjet e fundit
- humbja ose vendosja e gabuar e gjërave
- humbja e orientimit gjatë ecjes ose vozitjes
- duke u hutuar, edhe në vende të njohura
- duke humbur ndjenjën e kohës
- vështirësi në zgjidhjen e problemeve ose marrjen e vendimeve
- vështirësi gjatë mbajtjes së bisedës ose vështirësi në gjetjen e fjalëve
- vështirësi në kryerjen e detyrave të njohura
- vlerësimi i gabuar i distancave nga objektet vizualisht.

Ndryshimet e zakonshme në humor dhe sjellje përfshijnë:

- ndjenjën e ankthit, trishtimit ose të zemërimit për humbjen e kujtesës
- ndryshimet e personalitetit
- sjellje të papërshtatshme
- tërheqja nga puna ose aktivitetet shoqërore
- mosinteresimi për emocionet e njerëzve të tjerë.

Demenca prek çdo person në një mënyrë të ndryshme, në varësi të shkaqeve themelore, kushteve të tjera shëndetësore dhe funksionimit kognitiv të personit përpara se të sëmuret.

Shumica e simptomave përkeqësohen me kalimin e kohës, ndërsa të tjerat mund të zhduken ose të shfaqen vetëm në fazat e mëvonshme të demencës. Ndërsa sëmundja përparon, nevoja për ndihmë me kujdesin personal rritet. Njerëzit me demencë mund të mos jenë në gjendje të njohin anëtarët e familjes ose miqtë, të kenë vështirësi në lëvizje, të humbasin kontrollin mbi kryerjen e nevojave fiziologjike, të kenë probleme me ngrënien dhe pirjen dhe të përjetojnë ndryshime në sjellje, si agresioni. Të gjitha këto janë shqetësuese për personin me demencë, ashtu dhe për ata rreth tyre.

Tabela 1.

Vlerësimi demencës

1) Kërkoni shenja dhe simptoma të demencës
2) Përfshijni deliriumin, depresionin
3) Kërkoni probleme të tjera mjekësore
4) Vlerësoni simptomat njohëse
5) Vlerësoni simptomat jo-njohëse (të sjelljes) dhe psikologjike
6) Përfshijni çrregullime të tjera të shëndetit mendor ose abuzimit të substancave
7) Vlerësoni problemet dhe nevojat e kujdestarëve

1.2 Format e zakonshme të demencës

Demenca shkaktohet nga shumë sëmundje ose lëndime të ndryshme që dëmtojnë drejtpërdrejt dhe tërthorazi trurin. Sëmundja e Alzheimerit është forma më e zakonshme dhe mendohet se kontribon në 60- 70% të rasteve. Forma të tjera përfshijnë demencën vaskulare, demenca me trupa Lewy (depozita jonormale të proteinave brenda qelizave nervore) dhe një grup sëmundjesh që kontribojnë në demencën frontotemporale (degjenerimi i lobit frontal të trurit). Demenca mund të zhvillohet gjithashtu pas një goditjeje ose në kontekstin e disa infeksioneve si HIV, si rezultat i keq përdorimit të alkoolit, dëmtimeve të përsëritura fizike në tru (të njohura si encefalopatia kronike traumatike) ose mangësive ushqyese.

Kufijtë midis formave të ndryshme të demencës janë të paqartë dhe format e përziera shpesh bashkë ekzistojnë.

Tabela nr 2.

Nëntipet më të shpeshta të demencave ireverzibile

Demencia nëntipi	Karakteristikat Klinike	Neuropatologjia	Proporcioni i rasteve të demencës
Alzheimer sëmundje (AD)	Kujtesa e dëmtuar, apatia dhe depresioni gradual	Amiloidi kortikal Pllaka dhe fillimi i krijimit të lëmshave neurofibrilarë	50-75%
Demencia vaskulare(VaD)	Ngjashëm me AD,por me kujtesë dhe humor më pak të prekur	Sëmundje cerebrovaskulare Infarkt në regjionet kritike ose më shumë sëmundje difuze me shumë infarkte trunore	20-30%
Demencia me trupat Lewy (DLB)	Luhatje të theksuara në aftësinë njohëse Halucinacione vizuale Parkinsonizëm (dridhje dhe ngurtësi)	Lewy trupat kortikalë (alfa-sinukleinë)	< 5%
Demence fronto-temporale (FTD)	Ndryshimet e personalitetit Ndryshimet e humorit Disinhibimi Vështirësitë gjuhësore	Asnjë patologji e vetme-dëmtimi i kufizuar në lobet frontale dhe temporale në fazat fillestare	5-10%

2. Qëllimi dhe fokusi

Qëllimi i këtij udhërrëfyese është që të ofrojë udhëzime të bazuara në evidencat e fundit për diagnostikimin dhe menaxhimin e pacientëve me demencë. Udhërrëfyese synon të përmirësojë cilësinë e kujdesit shëndetësor përmes zbatimit të evidencës nga hulumtimet e reja shkencore në punën e përditshme praktike. Udhërrëfyese ka për qëllim të përmirësojë kujdesin duke bërë rekomandime për trajnimin e stafit të bazuara në evidencat e fundit shkencore duke ndihmuar antatarët e familjes dhe kujdestarët për të mbështetur njerëzit që jetojnë me demencë.

Ky udhërrëfyese do të jetë në interes për të gjithë profesionistët shëndetësor, në të gjitha nivelet, të cilët janë të përfshirë në menaxhimin e pacientëve me demencë, duke përfshirë: doktorë të mjekësisë, specialist të mjekësisë familjare, specialist të neurologjisë dhe të psikiatrisë. Gjithashtu në këtë udhërrëfyese ka të dhëna të rëndësishme edhe për stafin e mesëm, specialistët e shëndetit publik dhe farmacistët.

Përcjellja e rekomandimeve të dhëna në këtë udhërrëfyes nuk e garanton suksesin në trajtimin secilit pacient. Vlerësimi klinik duhet të bëhet nga profesionistët shëndetësorë të cilët janë përgjegjës për vendimet që i marrin sa i përket planit të trajtimit dhe procedurave diagnostike të nevojshme. Poashtu, vendimi për përzgjedhjen e metodave të veçanta diagnostike dhe mjekimin, duhet të ndërmerret me miratimin e pacientit apo familjarëve të pacientit.

2.1 Epidemiologjia

- Sipas OBSH-së aktualisht më shumë se 55 milionë njerëz kanë demencë në mbarë botën, mbi 60% e të cilëve jetojnë në vende me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Çdo vit shfaqen afro 10 milionë raste të reja. Vlerësohet se veteëm në Europë diku rreth 10.5 milionë njerëz jetojnë me demencë dhe pritet që ky numër do të jetë 13.4 milionë në vitin 2030 .
- Demenca rezulton nga një sërë sëmundjesh dhe dëmtimesh që prekin trurin. Sëmundja e Alzheimerit është forma më e zakonshme e demencës dhe mund të paraqitet në 60-70% të rasteve.
- Demenca është aktualisht shkak i shtatë kryesor i vdekjeve dhe një nga shkaqet kryesore të paaftësisë dhe varësisë tek të moshuarit në mbarë botën.

Sipas vjetarit statistikor të Republikës së Kosovës në vitin 2022 në Kosovë janë regjistruar 116.785 njerëz mbi moshën 65 vjeçare dhe në bazë të prevalencës së standardizuar të moshës në shumicën e vendeve me demencë janë 5-7% të kësaj popullate, gjë që i bie që në Kosovë të jenë me demencë rreth 7000 njerëz.

2.2 Popullata e caktuar

- Pacientët që jetojnë me forma të ndryshme të demencës, duke përfshirë edhe sëmundjen e Alzheimerit.
- Familjarët dhe kujdestarët e tyre të përfshirë në përkujdesjen e pacientëve me forma të ndryshme të demencës.
- Pacientët që jetojnë me demencë duke u fokusuar në kujdesin dhe mbështetjen e përqëndruar në personin, të përshtatur për nevojat specifike të çdo personi që jeton me demencë.

2.3 Dedikimi i udhërrëfyesit

Te gjithë pacienteve që jetojnë me forma të ndryshme të demencës duke përfshirë edhe sëmundjen e Alzheimerit, të cilët kanë nevojë për diagnostikim dhe menaxhim të sëmundjes.

Ky udhërrëfyes do të jetë në interes për të gjithë profesionistët shëndetësor, në të gjitha nivelet, të cilët janë të përfshirë në menaxhimin e pacientëve me demencë, duke përfshirë doktorët e mjekësisë, specialistët e mjekësisë familjare, specialistët e neurologjisë dhe psikiatrisë. Gjithashtu në këtë udhërrëfyes ka të dhëna të rëndësishme edhe për stafin e mesëm dhe specialistët e shëndetit publik.

Në mënyrë që ky udhërrëfyes klinik të ketë zbatim dhe ndikim direkt në menaxhimin adekuat të pacientëve me demencë, pa dyshim që nevojitet mbështetje nga Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet vartëse shëndetësore për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme dhe furnizimin me barna dhe mjete që mundësojnë diagnostikimin dhe menaxhimin e demencës.

2.4 Pyetjet klinike.

Ky Udhërrëfyes i adreson këto pyetje klinike:

1. Cilat janë kriteret klinike, neuropsikologjike dhe imazherike të diagnostikimit të demencës duke përfshirë dhe sëmundjen Alzheimerit?
2. Cilat janë metodat ndihmëse laboratorike që mund të përdoren për diagnostikimin e demencës duke përfshirë edhe sëmundjen Alzheimerit?
3. Cila është dobia e trajtimit të hershëm të pacientëve me demencë?
4. A duhet pacientëve, të cilat nuk janë të hospitalizuar, e të cilët janë me këtë diagnozë dhe që janë në përkujdesje të familjarëve, t'u ofrohet kontrolla sistematike përcjellëse në institucione të specializuara pra klinika neurologjike?
5. Si duhet trajtuar simptomat bihejviorale, jo- njohëse të pacientët me demencë?
6. Cila është rëndësia e një kujdesi multidisciplinar pra të koordinuar për pacientët me demencë?
7. Cila është rëndësia e trajnimit të stafit në të gjitha nivelet për përkujdesje të pacientëve me demencë?
8. A duhet pacientët me Alzheimer respektivisht llojet e tjera të demencës dhe agjitim/sjellje agresive të trajtohen me antipsikotikë modernë (atipikë) në krahasim me haloperidol?

9. A duhet pacientët të cilët janë me Alzheimer apo demencë tjetër, pas një ose më shumë kriza epileptike pas diagnostikimit të trajtohen me levetiracetam/lamotrigine apo me karbamazepinë/fenitoinë/ valproat?

10. A duhet pacientët me fibrilacion atrial dhe demencë (pa insulte të mëparshme, aty ku ka indikacion për terapi antikoagulante) të trajtohen me antikoagulantë ?

11. A ndihmon menaxhimi sistematik i faktorëve vaskularë të rrezikut te pacientët me demencë në ngadalësimin e përparimit të demencës?

3. Metodologjia

3.1 Formatimi

Ky Udhërrëfyes është përshtatur nga Grupi punues profesional multidisciplinar 6-anëtarësh i emëruar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, me kontributin edhe të shumë bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Anëtarët e Grupit punues para fillimit të përgatitjes së këtij Udhërrëfyesi janë deklaruar se nuk kanë ndonjë konflikt interesi për çka edhe i kanë nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit.

Takimet janë aranzhuar nga kryesuesi i Grupit punues në mënyrë që të marrin pjesë të gjithë anëtarët e Grupit dhe çdo herë është mbajtur procesverbali. Që nga takimi i parë janë ndarë detyrat dhe në takimet e radhës dhe secili anëtar ka raportuar për punën e bërë. Diskutimet janë bërë bashkarisht në grup për të gjitha paqartësitë dhe dilemat.

Pas analizimit të materialit dhe diskutimeve mes anëtarëve të Grupit punues janë zgjedhur për t'u adaptuar rekomandimet e fundit të literaturës bashkëkohore, si për diagnostikim ashtu për trajtim, të cilat përmbajnë informata mjekësore të bazuar në evidencë dhe të cilat janë shqyrtuar që të jenë të përshtatshme dhe aplikueshme për rrethanat e vendit tonë.

Udhërrëfyesi është hartuar në përputhje me metodologjinë standarde të procesit të përshtatjes së udhërrëfyesve, të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2019 për Udhërrëfyes dhe Protokolle Klinike si dhe duke u shërbyer me dokumentin AGREE. Marrja e vendimeve nga anëtarët e Grupit punues është bërë me konsensus, pra me pëlqimin e plotë të të gjithë anëtarëve. Në rastet e veçanta kur ka pasur mospajtim, vendimet janë marrë me votim të shumicës së anëtarëve prezentë në takim.

Rishqyrtuesit e këtij Udhërrëfyesi janë konsultuar disa herë gjatë përpunimit të materialit dhe në fund anëtarët e grupit punues e kanë pasur në dispozicion edhe draftin e plotë. Vërejtjet, këshillat dhe rekomandimet e tyre që i janë dorëzuar Grupit punues janë diskutuar dhe analizuar me

kujdes, dhe pas vërtetimit të bazës shkencore të tyre, janë përfshirë në draftin final.

Duke u bazuar në trendët shkencorë të këtij lëmi, si nga aspekti diagnostikues ashtu edhe mjekues, përditësimi i këtij Udhërrëfyesi rekomandohet të bëhet pas 5 vitesh, nëse nuk ka ndonjë arsye për ndonjë përditësim më të hershëm.

Pas miratimit, ky Udhërrëfyesi do të jetë në dispozicion për t'u shpërndarë dhe prezantuar të gjithë profesionistëve shëndetësorë, të cilët bazuar në kompetencat e tyre të përcaktuara do ta bëjnë zbatimin e tij. Grupi punues do të jetë i gatshëm për sqarime të përmbajtjes së dokumentit për të gjithë.

3.2 Burimet

Ky Udhërrëfyesi është adaptuar nga:

a).Nice guideline.Dementia; Assesment, management and support for people living with dementia and their carers, NICE guideline [NG97], update 2024.

b).Medical management issues in dementia-protocol for the European Academy of Neurology Guideline. European Journal of Neurology 2020, 0: 1–16.

c).Clinical Practice Guidelines for Management of Dementia. Indian J Psychiatry.2018 Feb;60(Suppl 3):S312–S328. doi: 10.4103/0019-5545.224472.

Udhërrëfyesit e përzgjedhur kanë përmbushur kriteret e parapara për arsye se kanë dhënë përgjigje në mbi 90% të pyetjeve klinike të formuluar nga grupi i ekspertëve për hartimin e udhërrëfyesit.

4. Rekomandimet

Rekomandimet në vazhdim janë theksuar nga grupi punues i udhërrëfyesit si rekomandime kryesore klinike e që duhet të kenë prioritet për implementim.

Grada e rekomandimit ndërlidhet me fuqinë e evidences në të cilën është mbështetur rekomandimi. Kjo nuk nënkupton rëndësinë klinike të rekomandimit.

Ky udhëzues përfshin rekomandimet për:

- 4.1 Përfshirja e njerëzve që jetojnë me demencë në vendimet për kujdesin e tyre
- 4.2 Diagnoza
- 4.3 Koordinimi i kujdesit
- 4.4 Ndërhyrjet farmakologjike për demencën
- 4.5 Menaxhimi i simptomave jo njohëse
- 4.6 Kujdesi paliativ
- 4.7 Mbështetja e kujdestarëve
- 4.8 Trajnimi dhe edukimi i stafit
- 4.9 Termat e përdorur në këtë udhëzues

4.1 Përfshirja e njerëzve që jetojnë me demencë në vendimet për kujdesin e tyre

4.1.1 Përfshirja e njerëzve në vendimmarrje

Inkurajoni dhe mundësoni njerëzit që jetojnë me demencë të japin pikëpamjet dhe opinionet e tyre për kujdesin e tyre.

Nëse është e nevojshme, përdorni mënyra shtesë ose të modifikuara të komunikimit (për shembull ndihmesa vizuale ose tekst i thjeshtuar).

Duhet pasur parasysh përdorimi i një mjeti të strukturuar për të vlerësuar pëlqimet dhe mospëlqimet, rutinat dhe historinë personale të një personi që jeton me demencë.

4.1.2 Dhënia e informacionit

Të ju ofrohet njerëzve që jetojnë me demencë dhe anëtarëve të familjes së tyre ose kujdestarëve të tyre (sipas rastit), informacion që është i rëndësishëm për rrethanat e tyre dhe fazën e gjendjes së tyre.

Në diagnozë, ofroni personit dhe anëtarëve të familjes ose kujdestarëve të tyre (sipas rastit) informacion me gojë dhe me shkrim që shpjegon:

- Cili është nëntipi i demencës që ata kanë dhe ndryshimet që duhen pritur përredisa gjendja është duke përparuar.
- Cilët profesionistë të kujdesit shëndetësor dhe ekupe të kujdesit social do të përfshihen në kujdesin e tyre dhe si të kontaktohen me ta
- Nëse është e përshtatshme, si ndikon demenca në drejtimin e automjetit dhe se ata duhet t'i tregojnë institucioneve përkatëse për diagnozën e tyre të demencës
- Të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre ligjore
- Si mund të ndihmojnë grupet e mëposhtme dhe si t'i kontaktojnë
ata: Grupet lokale mbështetëse, forume në internet dhe bamirësi
kombëtare Shërbimet e këshillimit financiar dhe juridik
Shërbimet e avokatisë.

Nëse nuk është dokumentuar më herët, pyesni personin me diagnozë të demencës:

- Për pëlqimin e tyre për shërbimet për të shkëmbyer informacion
- Me cilët njerëz dëshirojnë që shërbimet, të ndajnë informacionin (për shembull anëtarët e familjes ose kujdestarët)
- Çfarë informacioni dëshirojnë që shërbimet të ndajnë.

Dokumentoni këto vendime në të dhënat e personit.

Pas diagnostikimit, i drejtoni njerëzit dhe anëtarët e familjes ose kujdestarët e tyre (sipas rastit) te shërbimet përkatëse për informacion dhe mbështetje mbi koordinimin e kujdesit).

Për njerëzit që nuk duan takime të radhës dhe që nuk përdorin shërbime të tjera, i pyetni nëse dëshirojnë të kontaktohen përsëri në një datë të caktuar të ardhshme.

Sigurohuni që njerëzit që jetojnë me demencë dhe kujdestarët e tyre të dinë se si të marrin më shumë

informacion dhe nga kush nëse ndryshojnë nevojat e tyre.

Tregojuni njerëzve që jetojnë me demencë (në të gjitha fazat e gjendjes) për studimet kërkimore në të cilat mund të marrin pjesë.

4.1.3 Planifikimi i kujdesit paraprak

Ofroni mundësi të hershme dhe të vazhdueshme për njerëzit që jetojnë me demencë dhe njerëzit e përfshirë në kujdesin e tyre për të diskutuar:

- Përparësitë e planifikimit përpara
- Prokurë (autorizim) të qëndrueshëm (për vendimet për shëndetin dhe mirëqenien dhe vendimet për çështjet pronësore dhe financiare)
- Një deklaratë paraprake për dëshirat, preferencat, besimet dhe vlerat e tyre në lidhje me kujdesin e tyre në të ardhmen
- Vendimet paraprake për të refuzuar trajtimin
- Preferencat e tyre për vendin e kujdesit dhe vendin e vdekjes.

Shpjegoni se atyre do t'u jepet mundësia për të shqyrtuar dhe ndryshuar çdo deklaratë dhe vendim paraprak që ata kanë marrë.

Në çdo rishikim të kujdesit, u ofroni njerëzve mundësinë që të rishikojnë dhe të ndryshojnë çdo deklaratë dhe vendim paraprak që kanë marrë.

5. Diagnoza

5.1 Vlerësimi fillestar nga ana e mjekut në kujdesin shëndetësor primar

Në vlerësimin fillestar, merrni një anamnez të detajuar (përfshirë simptomat njohëse, të sjelljes dhe psikologjike si dhe ndikimin që kanë simptomat në jetën e tyre të përditshme):

- Nga personi me demencë të dyshuar dhe
- Nëse është e mundur, nga dikush që e njeh mirë personin (si p.sh. një anëtar i familjes).

Nëse pas vlerësimit fillestar ende dyshohet për demencë

- Kryeni një ekzaminim fizik dhe
- Ndërmerrni analizat e duhura të gjakut dhe urinës për të përjashtuar shkaqet e tjera të rënies njohëse dhe
- Përdorni testimin kognitiv.

Kur përdorni testimin kognitiv, përdorni një instrument njohës të strukturuar të vlefshëm, të tillë si:

- Mini mental State examination MMSE
- 10 Point Cognitive Screener
- 6 CIT -6 item Cognitive Impairment test
- Mini-Cog (Mini Cognitive Test)
- Memory Impairment Screen.

Mos e përjashtoni demencën vetëm sepse personi ka një rezultat normal në një instrument njohës.

Referojeni personin te një shërbim i specializuar diagnostikues i demencës (si p.sh. një Klinikë Neurologjike ose Klinikën Psikiatrike) nëse:

- Janë hetuar shkaqet reverzibile të rënies njohëse (duke përfshirë deliriumin, depresionin, dëmtimet shqisore (siç është humbja e shikimit ose dëgjimit) ose dëmtimi kognitiv nga ilaçet që lidhen me rritjen e ngarkesës antikolinergjike dhe
- Ende dyshohet për demencë.

Nëse personi dyshon për demencë progresive të shpejtë, referojuni një shërbimi neurologjik me qasje në teste (përfshirë ekzaminimin e lëngut cerebrospinal) për sëmundjen Creutzfeldt-Jakob dhe patologji të ngjashme.

5.1.2 Diagnoza në shërbimet e specializuara të diagnostikimit të demencës

Diagnoza e një nëntipi të demencës (nëse është e mundur) nëse vlerësimi fillestar i specialistit (duke përfshirë një ekzaminim të duhur neurologjik dhe testimin kognitiv) konfirmon rënien njohëse dhe eliminohen shkaktaret e tjerë dhe nëse shkaqet e demences së kthyeshme janë përjashtuar.

Nëse dyshohet për sëmundjen e Alzheimerit, e përdorni një test të kujtesës episodike verbale në vlerësim. Merrni parasysh testimin neuropsikologjik nëse është e paqartë:

- Nëse personi ka dëmtim kognitiv ose
- Nëse dëmtimi kognitiv shkaktohet nga demenca apo
- Cila është diagnoza e saktë e nëntipit.

Të përdoren kritere e vërtetuara për të udhëhequr gjykimin klinik kur diagnostikoni nëntipe të demencës, të tilla si:


- Kriteret ndërkombëtare të konsensusit për demencën me trupat Lewy

- Kriteret ndërkombëtare për demencën frontotemporale (FTD), (afazioni progresiv jo rrjedhës dhe demenca semantike)
- Kriteret ndërkombëtare për sëmundjen Creutzfeldt-Jakob.

Të kryhet imazheria përkatëse strukturore për të përjashtuar shkaqet reverzibile të rënies njohëse dhe për të ndihmuar në diagnozën e saktë për demencë si dhe të përcaktohet nëntipi, përveç nëse diagnoza e demencës është e sigurtë dhe nëntipi është i qartë.

Figura nr 1

Vlerësimi fillestar



Të përdoren (merren parasysh) testet plotësuese nëse:

- Do të ndihmonin në diagnostikimin e një nëntipi të demencës dhe
- Të ofrohen të dhëna të detajuara më shumë rreth nëntipit të demencës me kusht që kjo do të ndryshonte menaxhimin.

5.1.3 Testet plotësuese për sëmundjen e Alzheimerit

Nëse diagnoza është e pasigurtë dhe dyshohet për sëmundjen e Alzheimerit, të merret parasysh:

- FDG-PET (tomografia e emetimit të fluorodeoksiglukozës-pozitron-CT), ose SPECT perfuzioni (CT emetimi me një foton) nëse FDG-PET nëse nuk është në dispozicion.

ose

- Ekzaminimi i lëngut cerebrospinal për:

Ose tau proteinën totale ose tau totale dhe tau i fosforiluar

181 dhe Ose amiloid beta 1-42 ose amiloid beta 1-42 dhe

amiloid beta 1-40.

Nëse diagnoza nuk mund të vendoset pas këtyre ekzaminimeve, duhet te merret parasysh përdorimi i testeve tjera shtesë.


Duhet të keni parasysh se sa më i vjetër të jetë personi, gjasat më të mëdha janë për një rezultat të rrejshëm në ekzaminimin e lëngut cerebrospinal.

- Mos e përjashtoni sëmundjen e Alzheimerit vetëm duke u vetëm në rezultatet e skanimeve me CT ose MRI.
- Mos përdorni gjenotipizimin e Apolipoproteinës E ose elektroencefalografinë për të diagnostikuar sëmundjen e Alzheimerit.

Të keni parasysh se sëmundja e Alzheimerit në moshë të re ka më shumë gjasa që të ketë bazë gjenetike tek disa njerëz.

Figura 2

Konsideroni shpjegime të tjera për simptomat njohëse



Teste plotesuese për demencë me trupat Lewy

Nëse diagnoza është e pasigurtë dhe dyshohet për demencë me trupa Lewy, përdorni 123 I FP CIT SPECT.

Nëse 123 I FP CIT SPECT nuk disponohet, merrni parasysh shintigrafinë kardiake 123 I MIBG.

Mos e përjashtoni demencën me trupat Lewy bazuar vetëm në rezultatet normale në scintigrafinë kardiake 123 I FP CIT SPECT ose 123 I MIBG.

5.1.4 Teste plotesuese për demencën frontotemporale

Nëse diagnoza nuk mund të vendoset (shih rekomandimin 1.2.14) dhe dyshohet për demencë frontotemporale, përdorni ose:

- FDG-PET ose
- perfuzion SPECT.

Mos e përjashtoni demencën frontotemporale duke u bazuar vetëm në rezultatet e testeve të imazhit strukturor, perfuzionit ose metabolik.

Duhet të keni parasysh se edhe demenca frontotemporale ka gjasa të ketë bazë gjenetike tek disa njerëz.

5.1.5 Teste plotesuese për demencën vaskulare

Nëse nëntipi i demencës është i pasigurtë dhe dyshohet për demencë vaskulare, të bëhet MRI. Nëse MRI nuk është në dispozicion ose e kundërindikuar, të realizohet CT.

Mos e diagnostikoni demencën vaskulare bazuar vetëm në prezencën e lezionit vaskular.

Duhet të keni parasysh se demenca vaskulare në moshë të re zakonisht mund të jetë me bazë gjenetike.

Tabela nr 3

Kriteret diagnostike për demencë

Lloji i demencës	Kriteret diagnostike
Sëmundje e Alzheimerit	Shihni ICD-10 dhe DSM-5
Demencia vaskulare	Shihni ICD-10 dhe DSM-5
Demencia me trupat Lewy	Kriteret e rishikuar të konsensusit për demencën me trupat Lewy
Demencia fronto-temporale	Kriteret e konsensusit klinik diagnostikues për degjenerimin lobar fronto-temporal

5.1.6 Rishikimi pas diagnozës

- Pasi një person diagnostikohet me demencë, duhet t'i mundësohet që ai dhe anëtarët e familjes ose kujdestarët e tij të kenë qasje në një shërbim të specializuar ose shërbim ekuivalent të demencës multidisciplinar në kujdesin primar shëndetësor ose në ate sekondar pra në spital.
- Shërbimet multidisciplinare të demencës në kujdesin primar shëndetësor ose në ate sekondar pra spital, duhet të ofrojnë një zgjedhje të qasjes fleksibile në kuptim të orarit ose takimeve monitoruese të planifikuara.
- Kur njerëzit që jetojnë me demencë ose kujdestarët e tyre kanë një kontroll të caktuar në kujdesin parësor, vlerësoni për ndonjë nevojë të re të shfaqur lidhur me demencën ose nëse ata nëse kanë nevojë për më shumë mbështetje.

6. Trajtimi

6.1 Ndërhyrjet farmakologjike për demencën

6.1.1 Menaxhimi farmakologjik i sëmundjes Alzheimer

Tre frenuesit e acetilkolinesterazës (AChE) donepezil, galantaminë dhe rivastigmine si monoterapi rekomandohen si opsione për menaxhimin e sëmundjes së Alzheimerit fillestare deri të moderuar .

Monoterapia me memantinë rekomandohet si një opsion për menaxhimin e sëmundjes së Alzheimerit për njerëzit me:

- Sëmundje të moderuar të Alzheimerit, të cilët janë intolerantë ose kanë një kundërrindikacion ndaj frenuesve të AChE ose
- Sëmundja e rëndë e Alzheimerit.

Për njerëzit me një diagnozë të vendosur të sëmundjes Alzheimer që tashmë po marrin një frenues AChE:

- Të shtohet memantina te pacientët të cilët tashmë janë duke u trajtuar me një frenuesi tjetër të AChE , nëse ata kanë sëmundje të moderuar
- Të shtohet memantina te pacientët të cilët tashmë janë duke u trajtuar me një frenuesi tjetër të AChE , nëse ata kanë sëmundje të rëndë.

Nëse përshkruani një frenues AChE (donepezil, galantaminë ose rivastigmine), trajtimi duhet të fillojë normalisht me ilaçin me koston më të ulët të blerjes (duke marrë parasysh dozën e kërkuar ditore dhe çmimin për dozë pasi të ketë filluar kujdesi i përbashkët). Megjithatë, një frenues alternativ i AChE mund të përshkruhet nëse konsiderohet si i përshtatshëm kur merret parasysh profili i efekteve anësore, pritshmëritë për aderimin, koomorbiditeti mjekësor, mundësia e ndërveprimeve me ilaçet dhe profilet e dozimit.

Tabela nr 4 Trajtimi farmakologjik i demencës

Trajtimi farmakologjik i demencës
• Inhibitorët e kolinesterazës (donepezil, rivastigmine dhe galantamine) mund të përdoren për të gjitha fazat e demencës për shkak të sëmundjes Alzheimer. • Memantina vetëm ose në kombinim me inhibitorët e kolinesterazës është e dobishme në demencën e moderuar deri në të rëndë për shkak të sëmundjes së Alzheimerit. • Donepenzil dhe rivastigmine mund të përdoren në demencë për shkak të demencës me trupat e Lewy-it dhe sëmundjes së Parkinsonit. • Inhibitorët selektiv të rimarrjes së serotoninës mund të përdoren në demencë fronto-temporale. • Doza të ulëta të antipsikotikëve atipik (risperidone, aripiprazole, quetiapine) mund të merren parasysh për agjitimit të rëndë, agresivitet dhe simptoma psikotike. • Stabilizuesit e humorit si divalproex natriumi dhe karbamazepina mund të jenë të dobishëm në menaxhimin e agjitimit.

Kur përdorin shkallët e vlerësimit për të përcaktuar ashpërsinë e sëmundjes së Alzheimerit, profesionistët e kujdesit shëndetësor duhet të marrin parasysh çdo paaftësi fizike, shqisore ose të mësuarit, ose vështirësi në komunikim, që mund të ndikojnë në vlerësimin dhe të bëjnë ndryshimet e nevojshme.

Gjatë vlerësimit të ashpërsisë së sëmundjes së Alzheimerit dhe nevojës për trajtim, profesionistët e kujdesit shëndetësor nuk duhet të mbështeten vetëm në rezultatet e vlerësimit të rënies kognitive në rrethana në të cilat do të ishte e papërshtatshme për ta bërë këtë. Kjo përfshin:

- Nëse rezultati i vlerësimit të rënies kognitive ose nuk është një mjet klinikisht i përshtatshëm për vlerësimin e ashpërsisë së demencës së atij pacienti për shkak të vështirësive të të mësuarit të pacientit ose aftësive të tjera të kufizuara (për shembull, dëmtimeve shqisore), vështirësive gjuhësore ose të tjera të komunikimit ose vështirësi që lidhen me nivelin e arsimit ose
- Nëse nuk është e mundur të aplikohet mjeti në gjuhën, të cilën pacienti e flet mjaftueshëm rrjedhshëm që të jetë i përshtatshëm për vlerësimin e ashpërsisë së demencës ose
- Nëse ka arsye tjera të ngjashme pse përdorimi i një rezultati, ose vetëm rezultati i vlerësimit të rënies kognitive, do të ishte i papërshtatshëm për vlerësimin e ashpërsisë së demencës.

Në raste të tilla, profesionistët e kujdesit shëndetësor duhet të përcaktojnë nevojën për fillimin ose vazhdimin e trajtimit duke përdorur një metodë tjetër të përshtatshme vlerësimi.

6.1.2 Menaxhimi farmakologjik i demencës jo-Alzheimer

Ofroni donepezil ose rivastigmine për njerëzit me demencë të lehtë deri të moderuar me trupa Lewy.

- Konsideroni përdorimin e galantaminës vetëm për njerëzit me demencë fillestare deri në mesatare me trupa Levy dhe atë nëse donepezili dhe rivastigmina nuk tolerohen.
- Donepezili ose rivastigmine të konsiderohen për njerëzit me demencë të rëndë me trupa Levy.
- Të konsiderohet përdorimi i memantinës për njerëzit me demencë me trupa Levy nëse frenuesit e AChE nuk tolerohen ose janë kundërendikuar.
- Ta keni parasysh se përdorimi i frenuesve të AChE ose memantinë për njerëzit me demencë vaskulare mund të bëhet vetëm nëse dyshohet për sëmundjen shoqëruese të Alzheimerit, demencë të sëmundjes së Parkinsonit ose demencë me trupa Lewy.

- Mos ofroni frenues AChE ose memantinë për njerëzit me demencë frontotemporale.
Duhet marr parasysh se afazia logopenike, e cila më parë është përfshirë në disa udhëzime diagnostikuese për demencën frontotemporale, tani është treguar se shkaktohet më së shpeshti nga sëmundja e Alzheimerit.
- Mos ofroni frenues AChE ose memantinë për njerëzit me dëmtim kognitiv të shkaktuar nga skleroza multiple.

Emri i medikamentit	Doza fillestare e zakonshme në mg/ditë	Doza maksimale e rekomanduar mg/ditë	Efektet anësore	Vërejtje
---------------------	--	--------------------------------------	-----------------	----------

Inhibitorët e kolinesterazës				
Donepezil	5	10	Mundim, vjellje, diarre, pagjumësi, ngërçe muskulore, anoreksi, humbje peshe, bradikardi, sinkopi	Filloni me 5 mg një herë në ditë dhe rriteni në 10 mg një herë në ditë pas 4 javësh nëse toleranca është e mirë
Rivastigmine	3	12	Efektet anësore të ngjashme me donepezil por pak më të rënda	Filloni me 1.5 mg dy herë në ditë dhe rriteni me 3 mg në ditë çdo dy javë deri në 6 mg dy herë në ditë
Galantamina	8	24	Ngjashëm me	Filloni me 4 mg dy

			donepezil dhe rivastigmine	herë në ditë dhe rriteni në 8 mg çdo 4 javë deri në 12 mg dy herë në ditë
Fllaster transdermal rivastigmine	4.6 mg/fllaster 24 orë	9.5 mg/fllaster 24 orë	Irritime të herëpashër ëshme të lëkurës	Filloni me fllaster 4.6 mg/24 orë dhe rriteni në 9.5 mg/fllaster 24 orë pas katër javësh nëse toleranca është e mirë
Donepezili me lëshim të zgjatur	11.5	23	Efektet anësore më të rënda se gastrointestinale	Titrimi në dozë të lartë donepezil duhet të merret parasysh pas të paktën 3 muajsh mirëmbajtje me 10 mg donepezil
Antagonisti NMDA Memantina	10	20	Nuk ka efekte të rëndësishme negative	Filloni me 5 mg 2 herë në ditë dhe rriteni në 5 mg çdo javë dhe titroni në 10 mg dy

Tabela nr 5 . Medikamentet e miratuara kundër demencës**6.1.3 Ilaçet që mund të shkaktojnë dëmtime njohëse**

Kini parasysh se disa ilaçe të përshkruara zakonisht shoqërohen me rritje të ngarkesës antikolinergjike, dhe rrjedhimisht me dëmtim njohës.

Merrni parasysh minimizimin e përdorimit të barnave që lidhen me rritjen e ngarkesës antikolinergjike dhe nëse është e mundur kërkoni alternativa:

- Kur vlerësohet nëse duhet referuar një person të dyshimtë për demencë për diagnozë
- Gjatë rishikimit të mjekimeve me njerëzit që jetojnë me demencë.

6.1.4 Menaxhimi i simptomave jo njohëse

Agjitimi, agresivitet, shqetësim dhe psikoza

Përpara se të filloni trajtimin jo-farmakologjik ose farmakologjik për shqetësimin tek njerëzit që jetojnë me demencë, bëni një vlerësim të strukturuar për të:

- Duke hulumtuar arsyet e mundshme të shqetësimit të tyre dhe
- Kontrolloni dhe vlerësoni shkaqet klinike ose mjedisore të mundshme (për shembull dhembja, delirium ose kujdes i papërshtatshëm).

Si menaxhim fillestar dhe i vazhdueshëm, ofroni ndërhyrje psikosociale dhe mjedisore për të reduktuar shqetësimin tek njerëzit që jetojnë me demencë.

Ordinoni antipsikotikë për njerëzit që jetojnë me demencë vetëm kur janë:

- Në rrezik për të dëmtuar veten ose të tjerët ose
- Duke përjetuar agjitim, halucinacione ose deluzione që u shkaktojnë shqetësime të rënda.

Konsideroni se për njerëzit me demencë me trupa Levy ose demencë të sëmundjes së Parkinsonit, antipsikotikët mund të përkeqësojnë tiparet motorike të gjendjes dhe në disa raste të shkaktojnë reaksione të rënda të ndjeshmërisë antipsikotike . Të keni parasysh se ndërhyrjet mund të kenë nevojë të modifikohen për njerëzit që jetojnë me demencë.

Para se të filloni antipsikotikët, diskutoni përfitimet dhe dëmet me anëtarët e familjes ose

kujdestarët e tyre.

Kur përdorni antipsikotikë:

- Përdorni dozën më të ulët efektive dhe përdorni ato për kohën më të shkurtër të mundshme
- Rivlerësoni personin të paktën çdo 6 javë, për të kontrolluar nëse ka ende nevojë për mjekim.

Ndaloni trajtimin me antipsikotikë:

- Nëse personi nuk ka përmirësim të kënaqshëm dhe të vazhdueshëm nga marrja e tyre dhe
- Pas diskutimit me personin që i merr dhe anëtarët e familjes ose kujdestarët e tyre.

Sigurohuni që njerëzit që jetojnë me demencë, të mund të vazhdojnë të kenë qasje në intervenime psikosociale dhe mjedisore për shqetësime gjatë kohës që marrin antipsikotikë dhe pasi të kenë ndërprerë marrjen e tyre.

Për njerëzit që jetojnë me demencë dhe që përjetojnë agjitim ose agresion, ofroni aktivitete të personalizuar për të promovuar angazhimin, kënaqësinë dhe interesin.

Mos ofroni valproat për të menaxhuar agjitacionin ose agresionin tek njerëzit që jetojnë me demencë, përveç nëse kemi diagnozë tjetër ku këto ilaçe duhet dhënë .

Niveli i evidencës

Nuk është i aplikueshëm.

6. 1.5 Trajtimi i agjitimit dhe sjelljes agresive me antipsikotik atipik në krahasim me trajtimin jo- farmakologjik.

Përmbledhje e evidencave; Një total prej 4058 referencash u vlerësuan dhe shtatë referenca u përfshinë. Dy referenca të raportuara për rezultate të ndryshme nga i njëjti studim. Të gjitha studimet e përfshira ishin Studime Klinike të Randomizuara. Rezultatet e vlerësuara : 1. Mortaliteti; 2.

Agjitimi/ Agresioni

(Kritike); 3. Funksionet globale kognitive (e rëndësishme); 4. Efektet e rëndësishme anësore .

Studimet ishin mbi risperidone (0,25 deri në 2 mg), quetiapinë (25 deri në 200 mg) ose olanzapainë (2,5 deri në 15 mg). Meta-analiza nuk u krye për shkak të heterogjenitetit në popullatë, kohëzgjatjes së ndërhyrjeve dhe rezultateve. Nuk kishte dallime në vdekshmërinë ndërmjet ndërhyrjeve në të gjitha studimet (vlerësimet e pikës së rrezikut relativ 0.85-2.08; jo domethënëse) ose ngjarje të padëshiruara serioze, (vlerësimet e pikës së rrezikut relativ 0.89-1.9; jo domethënëse në të gjitha, përveç një studimi. Megjithatë, ka pasur , në përgjithësi, shumë pak të dhëna për të dy rezultatet, ndoshta për shkak të numrit relativisht të ulët të pacientëve dhe kohëzgjatjes së shkurtër të provave të

përfshira (6-36 javë; katër studime ≤ 12 javë). Për të dyja pra si për funksionin kognitiv global, ashtu edhe për agjitacionin/agresionin), nuk kishte asnjë ndryshim në vlerat e fituara midis trajtimit dhe placebo, përveç një studimi të vetëm. Asnjë nga studimet nuk raportoi mbi barrën e kujdestarit.

Niveli i evidencës

Niveli i evidencës u vlerësua si i ulët

Rekomandimi

Autorët arrijnë në përfundimin se rekomandimi është i dobët kundër trajtimit të pacientëve me demencë duke përfshirë dhe Alzheimerin dhe agjitimin/sjellje agresive me antipsikotikë moderne (atipikë) krahasuar me trajtim jo-farmakologjik.

Tabela nr 6

Medikamentet Psikotrope për trajtimin e simptomave të sjelljes te personalitetit te demenca

Lloji dhe medikamentet	Doza fillestare ditore	Doza finale ditore	Simptomat e trajtuara
Antipsikotik atipik			
Risperidoni	0.5 mg	1.0 mg (0.75 - 1.5 mg)	Psikozë dhe agjitim
Olanzapine	2.5 mg	5.0 mg (5 – 10 mg)	
Quetiapine	25 mg	200 mg (50 – 150 mg dy herë në ditë)	
Stabilizues i humorit			
Divalproex natriumi	125 mg	500 mg (250 – 500 mg dy herë në ditë)	Agjitim
Karbamazepina	200 mg	400 mg (200 – 500 mg dy herë në ditë)	
Inhibitorët selektiv të rimarrjes së serotoninës			
Citalopram	10 mg	20 mg (20 – 40 mg)	Depresion, ankth, psikozë dhe agjitim
Escitalopram	5 mg	10 mg (10 – 20 mg)	
Paroxetina	10 mg	20 mg (10 – 40 mg)	
Sertraline	25 mg	75 mg (75 – 100 mg)	

6.1.6 Trajtim i agjitimit dhe sjelljes agresive me antipsikotikë atipikë në krahasim me haloperidol

Duhet të keni parasysh se pacientë me demencë mund të bëhen të agjituar ose të tregojnë sjellje agresive gjatë rrjedhës të sëmundjes, pa ndonjë arsye specifike ose kur të përjetojnë stres (ndryshimet në ambientin rrethues gjatë hospitalizimit p.sh).Kjo mund të ndodhë si rezultat i vet gjendjes fizike ose si efekt anësor i barërave.

U identifikuan katër referenca që raportnin efektin e antipsikotikëve atipikë kundrejt haloperidolit. Tre studime ishin RCT(studime klinike te randomizuara) dhe një ishte një RCT me një dizajn të kryqëzuar, me Olanzapinë (2,5 deri në 7,5 mg). Nuk pati asnjë ngjarje në studimet që raportnin mbi vdekshmërinë ose efekte e padëshiruara serioze. Në lidhje me agjitimin /agresionin, dy studime të kryera mbi Risperidon raportuan se trajtimi me antipsikotikë atipikë përmirësoi rezultatet dhe dy studime, njëri mbi Risperidonin, tjetri për Olanzapinën, raportuan të kundërtën.

Niveli i evidencës

Niveli i evidencave u vlerësua si shumë i ulët.

Rekomandim

Autorët arrijnë në përfundimin se duhet të ketë një rekomandim të dobët në favor të trajtimit të pacientëve me demencë dhe agjitim/sjellje agresive me antipsikotikë modernë (atipikë) krahasuar me haloperidolin kur është i nevojshëm trajtimi farmakologjik i agjitimit/sjelljes agresive. Ndër antipsikotikët modernë (atipikë), risperidoni mund të konsiderohet si trajtimi i linjës së parë kur është i nevojshëm trajtimi farmakologjik i agjitimit/sjelljes agresive.

Arsyetimi për rekomandim

Antipsikotikët atipikë janë superiorë në krahasim me placebo në reduktimin e simptomave të sjelljes në pacientët me demencë, ndërsa haloperidoli nuk është. Te pacientët e moshuar, në rrethana të ndryshme, risperidoni është gjetur të jetë po aq efikas sa haloperidol. Për më tepër, disa studime shumë të mëdha vëzhguese, kanë treguar se haloperidol është i lidhur me vdekshmëri më të lartë, rrezik të

pneumonisë dhe sëmundjeve kardio-vaskulare në krahasim me antipsikotikët atipikë (përfshirë risperidonin).

6.1.7 Trajtim i pacientëve me fibrilacion atrial dhe demencë me antikoagulantë

Në një studim retrospektiv të grupit të pacientëve me demencë dhe fibrilacion atrial (por pa infarkt cerebrovaskular të mëparshëm), u raportuan rezultatet nga 3724 pacientë që u ndoqën për një periudhë mesatare prej 669 (805) ditësh. Pacientët ishin ose të pa trajtuar (për arsye të panjohura) ose të trajtuar me warfarinë. Trajtimi nuk ishte i lidhur me një rrezik të rritur për ngjarje hemorragjike të rënda [raporti i rrezikut 1.07, intervali i besimit (CI) 95% 0.82–1.39], një rrezik të ulur të vdekshmërisë (raport i irrezikut 0.88, CI 95% 0.77–1.01) dhe infarkt cerebrovaskular ishemic (raport i irrezikut 0.74, CI 95% 0.54–1.03).

Niveli i evidencës

Niveli i evidencës u klasifikua si shumë i ulët

Rekomandimi

Rekomandim për trajtimin me antikoagulantë të pacientët me demencë (pa infarkt cerebrovaskular të mëparshëm) dhe fibrilacion atrial është i nivelit të dobët.

Justifikimi për rekomandim

